



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 01/65

Datë: 26.02.2022

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 3 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 2022, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Departamentit të Rezervave Shtetërore - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që t'u mundësohet përjashtimi nga procedurat e prokurimit për furnizim me produkteve të Rezervës Shtetërore të Mallrave, duke e klasifikuar lëndën e kontratës si sekret, në bazë të Ligjit Nr. 03/L-244 për Rezervat Shtetërore të Mallrave, dhe Rregullores (QRK) Nr. 03/2019 për Prokurimin për Qëllime të Mbrojtjes dhe të Sigurisë.
2. Obligohet Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Albin KURTI**

Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë